



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 150, datë 16.12.2019

PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. JOANA ASIMI SORRAJ NË VENDIN VAKANT PËR INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË, SHPALLUR NGA KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI NË DATËN 01.03.2019 DHE RISHPALLUR PËR PLOTËSIMIN E KANDIDATURAVE NË DATËN 09.09.2019

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ardian Dvorani	- Kryetar
Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare
Margarita Buhali	- Anëtare/Relatore
Fatjona Memçaj	- Anëtare
Eriol Roshi	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Dorina Dulaj**,

Me praninë e Avokates së Popullit, znj. **Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **z. Bledar Dervishaj**, përfaqësuesi i autorizuar i Presidentit të Republikës,

në mbledhjen e datës **16.12.2019** mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI PËR

INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË: Znj.Joana Asimi Sorraj

OBJEKTI:

Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së znj.Joana Asimi Sorraj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi shqyrtoi relacionin e anëtares relatores të Këshillit, znj. Margarita Buhali; dëgjoi mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës;

zhvilloi intervistën me kandidatin Joana Asimi Sorraj lidhur me motivimin e kandidimit, platformën, vizionin, si edhe objektivat e kandidatës nëse emërohet;

shqyrtoi dokumentacionin e kandidimit të paraqitur sipas kërkesa të ligjit dhe akteve nënligjore normative të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga kandidatja Joana Asimi Sorraj;

dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr.141 datë 02.12.2019, ka vendosur lejimin e kandidimit të kandidatës Joana Asimi Sorraj në vendin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, shpallur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 01.03.2019 dhe rishpallur për plotësimin e kandidaturave në datën 09.09.2019

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtarja e Këshillit, znj. Margarita Buhali, në cilësinë e relatores për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja Joana Asimi Sorraj në momentin e kandidimit dhe në aktet e dokumentet e tjera që janë administruar gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, anëtarja e Këshillit zonja Margarita Buhali, në cilësinë e relatores për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të kandidaturës së kandidatës Joana Asimi Sorraj për këtë vend vakant.

4. Në përfundim të procedurave të verifikimit dhe vendimeve të dhëna për lejimin ose ndalimin e kandidimit për të gjithë kandidatët në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, anëtarja relatorë, znj. Margarita Buhali, ka njoftuar Kryetarin dhe ka paraqitur për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit, relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për secilin kandidat të këtij vendi vakant lidhur me procedurën e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidaturave.

5. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me Vendimin nr.145, në datën 11.12.2019 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

6. Gjithashtu, me vendimin nr.146 dhe nr.147 të datës 11.12.2019, Këshilli ka miratuar kalendarin e intervistave me kandidatët e lejuar, si edhe listën e ekspertëve për gjuhët e huaja për dhënien e mendimit teknik për nivelin e zotërimit të tyre nga kandidatët.

7. Në mbledhjen e tij të datës 11.12.2019, Këshilli shqyrtoi relacionin dhe procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga anëtarja e Këshillit relatorë e vendit vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim lidhur me secilin kandidat. Gjithashtu, Këshilli dëgjoi edhe mendimin e Avokatit të Popullit që, në thelb, nuk paraqiti vërejtje lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatës Joana Asimi Sorraj.

8. Pas këtyre veprimeve, në vijim të mbledhjes, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka zhvilluar procedurën e intervistës me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

9. Intervista mbi motivimin e kandidimit me kandidatin e lejuar, znj. Joana Asimi Sorraj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, u zhvillua në datën 11.12.2019.

10. Lidhur me nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja nga kandidatja e lejuar, znj. Joana Asimi Sorraj Këshilli vlerësoi të mos caktojë ekspert, bazuar në faktin se kandidatja ka mbaruar studimet universitare në Itali dhe ka dokumenta nëpërmejt të cilave provon se zotëron edhe gjuhën angleze.

11. Në përfundim të intervistës, në zbatim të pikës 2 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli ka vijuar veprimtarinë e tij duke qëndruar i mbledhur për të realizuar vlerësimin e meritave profesionale, morale dhe organizative, drejtuese e menaxheriale të secilit kandidat, pasuar nga pikëzimi përkatës i këtyre meritave për secilin kriter ligjor. Kjo procedurë vlerësimi përfundoi në datën 16.12.2019, ditë në të cilën Këshilli arsyetoi dhe përcaktoi pikët për secilën kriter ligjor vlerësimi të secilit kandidat dhe në total pikëzimin e kandidimit për të gjitha meritat profesionale, morale dhe organizative, drejtuese e menaxheriale. Për këtë qëllim, në të njëjtën ditë Këshilli publikoi edhe rezultatin paraprak të pikëzimit për secilin nga pesë kandidatët e lejuar për kandidim në vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sipas ligjit, pas verifikimit të nevojshëm në mbledhjen e ardhshme të Këshillit, vendoset edhe miratimi i Listës Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të Lejuar për këtë vend vakant, si edhe raporti i arsyetuar i Këshillit lidhur me këtë renditje.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

12. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, mendimin e ekspertes për nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidatës Joana Asimi Sorraj në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumentet e paraqitura prej saj sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka vënë në bisedim vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatës Joana Asimi Sorraj për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës;
- b) në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;

c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimit më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 2 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;

ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 52 datë 21.06.2019 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

13. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Joana Asimi Sorraj ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

- a. Asistent pedagoge e jashtme per periudhen Tetor – Dhjetor 2003 në Universitetin Ismail Qemali Vlore.
- b. Asistent Pedagoge, për periudhën “janar 2004 – shtator 2005”, pranë Universitetit Ismail Qemali Vlorë;
- c. Pedagoge, për periudhën “shtator 2005- 25 mars 2006”, pranë Universitetit Ismail Qemali Vlorë;
- d. Specialiste pranë Këshilltarit Ligjor, për periudhën “27 mars 2006 – 07 nëntor 2007”, pranë Presidentit të Republikës;
- e. Specialiste për Marrëdhëniet me gjyqësorin, për periudhën “7 nëntor 2007 – 30 janar 2013”, pranë Presidentit të Republikës;
- f. Specialiste për Marrëdhëniet me gjyqësorin, për periudhën “30 janar 2013-31 janar 2014”, pranë Presidentit të Republikës listë pritje;
- g. Juriste për periudhën 1 shkurt 2014 deri 30 shtator 2015 pranë projektit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Projekti “Shërbime Sociale Inovative”;
- gj. Specialiste Drejtoria Juridike, për periudhën “19 shkurt 2016 – 16 shkurt 2017”, pranë Bashkisë Tiranë;
- h. Specialiste, për periudhën “16 shkurt 2017 – 30 nëntor 2017”, pranë Bashkisë Tiranë;
- i. Këshilltare ligjore, për periudhën “ 1 dhjetor 2017 – Aktualisht”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

14. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se kandidatja Joana Asimi Sorraj, në momentin e vlerësimit, ka gjithsej **15 vjet e 5 muaj** vjetërsi në punë në fushat e përcaktuara sipas nenit 147/d paragrafi 3 të Kushtetutës dhe **15 vjet e 1 muaj** vjetërsi në punë deri në momentin e kandidimit (**09 Shtator 2019**).

Historiku Arsimor

15. Në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr.115.2016, përcaktohet si kriter vlerësimi rezultatet e arritura nga kandidati gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë. Në zbatim të këtij kriteri vlerësues ligjor, me vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe me orientimet e përcaktuara në “Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e

kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë” (miratuar nga KED me vendimin nr.52 datë 21.06.2019), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka çmuar që të vlerësohen me 1 pikë kandidatët që kanë pasur notë mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë për notën mesatare mbi 9.

16. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Joana Asimi Sorraj ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 2003 si jurist, në Fakultetin e Leces, Itali. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

17. Diploma e certifikimit si Juriste, në Universitetin e Leçes Itali, është njohur me dëshminë për njohje diplomimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me nr. regjistri 217, datë 22.12.2005 dhe nota mesatare e studimeve është 8.7;

18. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “historiku arsimor”, nisur nga nota mesatare **8.6** e arritur gjatë studimeve dhe diplomimit në Fakultetin e Leces Itali, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Joana Asimi Sorraj me **1 (një) Pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

19. Në shkronjën “ç” të pikës 1 dhe shkronjat “a” e “b” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr.115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohen si kritere vlerësimi pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

20. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin nr. 52 datë 21.06.2019.

21. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Joana Asimi Sorraj ka ndjekur studimet pasuniversitare të Masterit në Departamentin e së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në periudhën 2005-2007, me vlerësimin nota mesatare 8.71, duke marrë titullin “*Master*”;

22. Gjithashtu, rezulton që kandidatja Joana Asimi Sorraj ka ndjekur studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, për Doktorante, Grada shkencore “Doktor” në Fakultetin e Drejtësisë, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë. Universiteti i Tiranës, në periudhën 2011-2017, ku është vlerësuar me notë mesatare 86 Pikë “Shumë mirë”.

23. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “gradë shkencore”, nisur nga marrja e gradës shkencore “doktor i Shkencave”, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatën Joana Asimi Sorraj me **2 (dy) Pikë**.

24. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatës Joana Asimi Sorraj, në periudhën 2009-2012 ka kryer trajnime me tematika: Hartimi i shkresave zyrtare dhe komunikimi; Hartimi i kontratave; Hartimi dhe përafrimi i legjislacionit; Programi i zhvillimit funksional; Ruajtja e të dhënave personale Departamenti i Administratës Publike. Ndërsa në periudhën 2004 -2006 ka kryer trajnime në fusha të ndryshme të së drejtës për Pedagogët e Fakulteteve të Drejtësisë në Shqipëri Këshilli i Europës

25. Duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidatja Joana Asimi Sorraj për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmon ta vlerësojë me **1 (nje) Pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

26. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin nr. 52 datë 21.06.2019.

28. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Joana Asimi Sorraj zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe gjuhën Italiane si dhe se një mirë gjuhën Spanjolle dhe Ruse. Sipas deklaramentit të kandidatës niveli i zotërimit të gjuhës angleze dhe italiane është “shumë mirë” në të tre komponentët: të kuptuarit, të folurit dhe me shkrim.

29. Gjatë intervistës së zhvilluar me Këshillin në datën 11.12.2019, për verifikimin e shkallës së zotërimit të gjuhës italiane, kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk zhvilloi intervistë dhe bisedë me ekspertët e gjuhës së huaj, pasi nga Këshilli, u konkludua se nuk është e nevojshme për sa kohë kjo candidate ka përfunduar studimet e plota universitare në gjuhën italiane, si edhe disponon dokument të lëshuar nga University of Michigan, për certifikimin e njohurive në gjuhën angleze sipas Met Michigan English Test.

30. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatën Joana Asimi Sorraj për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **3 (tre) Pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

31. Në pikën 3 të nenit 147/d të Kushtetutës dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, krahas qenies jurist i spikatur, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

32. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh sipas vendimit normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin nr.52 datë 21.06.2019.

33. Në rastin e kandidatës Joana Asimi Sorraj Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e saj profesionale si asistent pedagoge dhe pedagoge, specialiste për marrëdhëniet me gjyqsorin pranë Presidentit të Republikës, juriste pranë Bashkisë Tiranë dhe këshilltare ligjore pranë Komisionit të pavarur të kualifikimit etj., si edhe nga kontribute të tjera profesionale të kësaj kandidate në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

34. Për sa i përket *vlerësimit sasior*, Këshilli mbështetet në të dhëna që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, ku evidentohet angazhimi i tij me kohë të plotë në funksione publike të rëndësishme sic është detyra e pedagoges së jashtme dhe detyra e këshilltares ligjore pranë komisionit të pavarur të kualifikimit me përgjegjësi, kompetenca dhe ngarkesë punë të dallueshme e të posaçme ku përfshihen ndërmjet të tjerave edhe funksionet e tjera publike të përmendura në pikën 33 më sipër krahas veprimtarive e detyrave të tjera që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumente të tjera provuese të administruara në dokumentacionin e kandidimit.

35. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar dhe duke pasur parasysh profilet e veprimtarive profesionale, rezulton se kandidatja Joana Asimi Sorraj në cilësinë e autores ka përgatitur artikuj shkencorë, publikime profesionale dhe dokumente të tjera profesionale, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë të fokusuara kryesisht në fushën e drejtësisë kushtetuese, fusha të ndryshme të së drejtës publike, të të drejtës penale ndërmjet të cilave kandidati ka zgjedhur të paraqesë pranë Këshillit dokumentet që tregohen më poshtë:

- a. Krimet seksuale si krime të luftës, konferencë shkencore ndërkombëtare, Ligji penal dhe zbatimi i tij, viti 2014;

- b. Mbrojtja ndërkombëtare e Romëve, Gjeopolitika nr. VIII, viti 2013, “Shqipëria dhe pakicat kombëtare, etnike dhe kulturore”;
- c. Revista periodike The Heritage nr. 9/2012, artikulli: Aspekti historik i autanazisë.
- d. Revista periodike The Heritage nr. 10/2013, artikulli: Aspekte historike të shtetësisë në Shqipëri.
- e. E drejta e mjedisit; e drejtë themelore e njeriut.
- f. Revista shkencore Illyrius nr. 3 viti 2013, artikulli: Aspekte historike të shtetësisë (vetëm kopertina)
- g. Mendimi shkencor gjithëshqiptar në pragshekullin e dytë të pavarësisë kombëtare, libri i përmbledhjeve nr. 7, gusht 2012, tema kriteret e vlerësimit të përgjegjësisë penale tek të miturit nën 18 vjeç.
- h. Konferenca e njëmbëdhjetë Ndërkombëtare Biznesi dhe Punësimi me tematikë “Prespektiva e ekonomisë dhe e biznesit të Kosovës dhe vendeve të tjera botërore në shekullin XXI”.
- i. Last International Conference of the Albanian Institute of Sociology, Proceedings, artikulli Euthanasia: an obligation to live or a right to die.

36. Mbështetur në këto të dhëna të lidhura me përgjegjësitë dhe funksionet e natyrës teknike e profesionale që ka ushtruar kandidatja, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të botuara, detyrat konkrete të realizuara prej saj në ushtrimin e detyrës, së kështilltares ligjore Këshilli vlerëson se në aspektin sasior kandidatja Joana Asimi Sorraj ka tregues të lartë dhe të dallueshëm të angazhimit profesional, i cili rezulton tejkalon nivelin e angazhimit të zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Joana Asimi Sorraj për këtë kriter ligjor vlerësimi me **4.8 (katër pikë tetë) Pikë**.

37. Për sa i përket *vlerësimit cilësor*, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Joana Asimi Sorraj, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej saj, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidates, dëshmojnë përgatitjen e spikatur juridike në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi.

38. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, kandidatja Joana Asimi Sorraj ka njoftuar Këshillin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “*Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional*” dhe “*Kualifikimin Shtesë Profesional*”, ka përzgjedhur pesë dokumentet profesionale si më poshtë:

- a. Krimet seksuale si krime të luftës, konferencë shkencore ndërkombëtare, Ligji penal dhe zbatimi i tij, viti 2014;
- b. Mbrojtja ndërkombëtare e Romëve, Gjeopolitika nr. VIII, viti 2013, “Shqipëria dhe pakicat kombëtare, etnike dhe kulturore”;
- c. Revista periodike The Heritage nr. 9/2012, artikulli: Aspekti historik i autanazisë.
- d. Revista periodike The Heritage nr. 10/2013, artikulli: Aspekte historike të shtetësisë në Shqipëri.
- e. E drejta e mjedisit; e drejtë themelore e njeriut.

39. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Joana Asimi Sorraj dhe, në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi. Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 2 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe në orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin nr.52 datë 21.06.2019 të KED-së .

40. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme të fushës së të drejtës më fokus kryesor çështje të drejtësisë kushtetuese me theks të veçantë të të drejtat e themelore të njeriut, aspekte të rëndësishme të zhvillimit historik të institutit të shtetësisë, konceptit juridike të autanazisë, çështje të së drejtës publike, mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit penal, etj..

41. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është *“Origjinaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit”*. Nisur nga profilet profesionale të kandidates Joana Asimi Sorraj përmbajtja e dokumenteve të analizuara, tematikës dhe dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës, grupe interesi, funksionarët publikë dhe publiku i gjerë, Këshilli vëren se pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në dokumentet e tjera të paraqitura, dëshmojnë qasje profesionale origjinale dhe të thelluara të çështjeve ligjore të përzgjedhura për trajtim, për të ka një interes të veçantë për njohje dhe zbatim. Për rrjedhojë, krahas origjinalitetit në përzgjedhjen e tematikave dhe trajtimin e tyre, kandidatja ka sjellë argumente dhe përfundime me interes, të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e debatit profesional e doktrinal në tërësi dhe në veçanti evidentojnë nevojën për ndryshime ligjore në të ardhmen në fushat përkatëse të trajtimeve të përzgjedhura.

42. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Origjinaliteti dhe/ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit”*, Këshilli e vlerëson kandidatja Joana Asimi Sorraj me **4.8 (katër pikë tetë) Pikë**.

43. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me *“Aftësitë analitike”*, Këshilli vëren se veçanërisht në pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, kandidatja Joana Asimi Sorraj tregon zotërimin e aftësive shumë të mira për të analizuar problematikat ligjore në tematikat e zgjedhura dhe për të zbatuar institutet e të drejtës sipas natyrës dhe qëllimit të këtyre punimeve, duke arritur në kokluzione llogjike e ligjore.

44. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Aftësitë analitike”*, Këshilli e vlerëson kandidaten Joana Asimi Sorraj me **5.2 (pesë pikës dy) Pikë**.

45. Në lidhje me treguesin vlerësues *“Aftësitë kërkimore”*, Këshilli shqyrtoi veçanërisht pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Joana Asimi Sorraj, sikurse edhe dokumentet e tjerë profesionale të paraqitur në dosjen e kandidates. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të larmishme profesionale, të përdorura dhe të lidhura efektivisht me natyrën, qëllimin dhe përmbajtjen e secilit prej

punimeve të shqyrtuara, të nxjerra nga burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore vendase, si edhe doktrinës së shteteve të ndryshme dhe të institucioneve e gjykatave ndërkombëtare.

46. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli e vlerëson kandidatja Joana Asimi Sorraj me **3.6 (tre pikë gjashtë) Pikë**.

47. Sipas treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, verifikohet nëse në veprimtarinë e tyre profesionale, kandidatët kanë mbuluar me profesionalizëm tematikën e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Joana Asimi Sorraj, sikurse edhe i dokumenteve të tjerë profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të përcaktimit të tematikës dhe problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim të pasur dhe korrekt të terminologjisë juridike dhe strukturim e përdorim në mënyrën dhe vendin e duhur të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore shqiptare dhe e huaj.

48. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Saktësia dhe precizoni*”, Këshilli e vlerëson kandidatja Joana Asimi Sorraj me **4.6 (katër pikë gjashtë) Pikë**.

49. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Joana Asimi Sorraj, sikurse edhe dokumentet e tjerë profesionalë të paraqitur në dosjen e kandidatit. Këshilli vëren se në këto punime janë të organizuara dhe strukturuara në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur por njëkohësisht edhe korrekte, e thjeshtë dhe e një niveli të lartë profesional. Pasuria, qartësia e gjuhës së përdorur dhe organizimi i duhur i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.

50. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Joana Asimi Sorraj me **3.6 (tre pikë gjashtë) Pikë**.

51. Pas shqyrtimit dhe analizës së pesë indikatorëve të mësipërm që përbëjnë vlerësimin cilësor të dokumentacionit profesional të paraqitur nga kandidati, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Joana Asimi Sorraj me **21.8 (njëzet e një pikë tetë) Pikë**.

C. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

52. Në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin me karakter normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të spikatur profesionale përgjatë ushtrimit të profesionit sipas profileve përkatëse në fusha të ndryshme të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, shkencore, shkrimeve, ligjëratave dhe dokumenteve të tjera profesionale, të ketë përvoja apo të dëshmojë aftësi të treguar e të provueshme posaçërisht edhe në fushën e inspektimeve dhe hetimeve, duke përfshirë veprimtari verifikuese, hetimore a gjyqësore në fushën penale, civile, administrative, disiplinore ose të të drejtave të njeriut, sikurse edhe në

administratën publike, ose në çështjet e analizave të menaxhimit. Gjithashtu, kandidatët vlerësohen edhe në lidhje me pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

53. Rezultatet profesionale në lidhje me këtë kriter vlerësimi, shqyrtohen nga Këshilli për të vlerësuar veçanërisht rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojat e veçanta profesionale të kandidatit të cilat tregojnë vlera të spikatura profesionale në shërbim të drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave të këtij Institucioni, përfshirë këtu vlerësimin e njohurive të posaçme profesionale në lidhje me ushtrimin e kompetencave të kontrollit, inspektimeve, hetimeve disiplinore si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji.

54. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 10 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 7 pikë ekspertizën në fushat e së drejtës dhe posaçërisht në çështjet e drejtimit, organizimit dhe funksionimit të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, si edhe të ushtrimit të kompetencave me natyrë kontrolli, inspektimi, hetimi disiplinor si edhe kompetencave të tjera që përcaktohen nga ligji. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 3 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituarra sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin e KED nr.52 datë 21.06.2019.

55. Në rastin e kandidates Joana Asimi Sorraj, krahas jetëshkrimit, intervistës dhe motivimit për kandidim, Këshilli shqyrtoi dokumentet profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaritë e ndryshme profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidate në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime shkencorë, pjesëmarrjet në veprimtari të tjera profesionale të lidhura me fushat e së drejtës.

Përvoja dhe cilësi profesionale të posaçme për rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

56. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *relevanca e eksperiencës profesionale në lidhje me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Joana Asimi Sorraj, Këshillit i rezulton se historiku dhe karriera profesionale e kësaj kandidate është i fokusuar në pjesën më të madhe të kohëzgjatjes dhe shtrirjes së saj në fushën e drejtësisë kushtetuese, të drejtës publike dhe specialistet në marrëdhënie me gjyqsorin dhe këshilltares ligjore lidhur me problematikat ligjore e faktike të konstatuara gjatë rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit nga komisioni i pavarur i kualifikimit.

57. Nga ana tjetër, Këshilli vëren edhe se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar nga kandidatja Joana Asimi Sorraj, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive të tjera profesionale në fusha të ndryshme të së drejtës me kohë të pjesshme si pedagoge e jashtme në fushën e të drejtës publike, administrative, të drejtës romake, e të drejtës kushtetuese, të

drejtës penale të krahasuar. Nga ana tjetër, studimet pasuniversitare të ndjekura nga kandidatja si në programin master dhe në atë të doktoraturës janë fokusuar tek çështjet e të drejtës publike dhe fushave të tjera të së drejtës.

58. Nisur nga kjo veprimtari profesionale, Këshilli vlerëson se kandidatja Joana Asimi Sorraj dëshmon jo vetëm formimin e saj të plotë juridiko-profesional, por edhe se ka arritur një nivel të spikatur jo vetëm teorik por edhe të zbatimit e të ndikimit efektiv në praktikë, të specializimit dhe ekspertizës ligjore, të thelluar sidomos në fushën e të drejtës kushtetuese, në të drejtën publike, si edhe në çështjet e mirëadministrimit të veprimtarisë së institucioneve të drejtësisë, përfshirë edhe ato me përgjegjësi dhe kompetenca të natyrës kontrolluese dhe inspektuese ndaj gjyqtarëve e prokurorëve si subjekte të rivlerësimit.

59. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“përvojës dhe cilësive profesionale të posacme për rolin e funksionet e inspektorit të lartë të drejtësisë”*, nisur edhe nga kohëzgjatja e detyrave me natyrë inspektuese që kandidatja ka ushtruar ndaj subjekteve të rivlerësimit, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidates Joana Asimi Sorraj **3.8 (tre pike tetë) Pikë**.

Angazhime profesionale shitesë

60. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues, *angazhimeve profesionale shitesë*, sipas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidates Joana Asimi Sorraj, rezultojnë që përgjatë gjithë karrierës së saj profesionale, kjo kandidat ka qenë lektore e së drejtës kushtetuese, të drejtës publike, administrative, romake dhe penales së krahasuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, Universitetin Ismail Qemali në Vlorë, në Fakultetin Luarasi, në Universitetin jopublik Albania University. Këto angazhime shitesë janë kryer në të shumtën e kohës në cilësinë e pedagoges së jashtme dhe vazhdojnë pothuajse gjatë gjithë karrierës së saj profesionale nga viti 2003 deri në vitin 2016.

61. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shitesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të *“angazhimeve profesionale shitesë”*, ti caktojë kandidates Joana Asimi Sorraj **3 (tre) Pikë**.

Meritat Morale

62. Në zbatim të pikës 3 të nenit 147/d të Kushtetutës, si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për integritet të lartë moral dhe profesional. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter *“Rezultatet e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”*, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, përcaktohen si kritere vlerësimi edhe *“Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”* dhe *“cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi”*. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe *“angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”*. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

63. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 25 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 15 pikë *integritetin etik dhe moral*, deri në 8 pikë *reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve* dhe deri në 2 pikë *angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr.2 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin nr.52 datë 21.06.2019.

64. Në rastin e kandidatja Joana Asimi Sorraj, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të kësaj kandidateje.

Integriteti etik e moral

65. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Joana Asimi Sorraj në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon përkushtim dhe angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje, ndjeshmëri dhe respekt në komunikim e bisedë, duke parashtruar argumentet e tij me kompetencë, dinjitet, duke dëgjuar dhe përgjigjur me kujdesin e duhur, me durim e vetëpërbajtje përkundrejt qëndrimeve dhe pyetjet të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

66. Nga të dhënat e mundshme në dispozicion, Këshillit nuk i rezulton që kandidatja Joana Asimi Sorraj të ushtrojë apo të ketë ushtruar funksionet e saj profesionale duke favorizuar palë të caktuara apo duke kërkuar përfitime për veten apo për të tjerët. Nuk rezultojnë të dhëna që kjo kandidate të mos ketë respektuar detyrimin profesional të nderit dhe të dinjitetit, ndërtimit të marrëdhënieve profesionale dhe mirësjelljes në raport me kolegët, profesionistët e fushës, palët e përfshira në çështje pune etj.. Pra nuk ka të dhëna që me sjelljen dhe veprimtarinë e saj në jetën profesionale dhe personale të ketë cenuar apo të rrezikojë të cenojë imazhin dhe figurën publike të nëpunësit shtetëror dhe sistemit të drejtësisë.

67. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të "*integritetit etik e moral*" Këshilli e vlerëson kandidates Joana Asimi Sorraj me **15 (pesembëdhjetë) Pikë**.

Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

68. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues "*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*", nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatës me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se kandidatja Joana Asim Sorraj në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e tij

tregon angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave për zbatimin e drejtë të ligjit në ushtrimin e kompetencave dhe të përgjegjësisë, që i ngarkon ligji.

69. Sipas të dhënave që disponohen Këshilli vëren se kandidatja Joana Asim Sorraj ka përmbushur me korrekte detyrimet profesionale, duke i ushtruar me seriozitet, maturi dhe besnikëri funksionet e ndryshme gjatë karrierës profesionale si p.sh pedagoges, specialistet pranë këshilltarit juridik të Presidentit të Republikës, specialistet në drejtorinë e marrëdhënieve me gjyqsorin pranë presidentit të Republikës, këshilltares ligjore në komisionin e pavarur të kualifikimit etj.. Gjithashtu, kandidatja reflekton angazhim serioz dhe përgjegjshmëri të lartë gjatë prezantimit të saj në intervistën e realizuar para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Nga ana tjetër Këshilli vëren se nuk ka të dhëna që të tregojnë se ky kandidat në kryerjen e detyrës dhe në jetën personale të ketë kryer veprimtari që rezultojnë përtej kufijve ligjorë në raport me statusin dhe detyrat profesionale të kryera.

70. Prandaj, duke konstatuar se me sjelljen dhe veprimtarinë e tij përmbush të gjitha pritshmëritë e aspektit moral për marrjen e përgjegjësisë ligjore dhe institucionale, si edhe pritshmërinë e publikut për gëzimin e cilësive profesionale e morale për ushtrimin e detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në lidhje me kriterin vlerësues të “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” Këshilli e vlerëson kandidaten Joana Asimi Sorraj me **8 (tetë) Pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

71. Për sa i përket kriterit të trete vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidates me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshillit i rezulton se, përgjithësisht, kandidatja Joana Asimi Sorraj nuk ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera të përshtatshme jashtë atyre të lidhura me ushtrimin e detyrës ose të profesionit për ndjekje të kauzave të shoqërisë civile.

72. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*merita morale-angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*” Këshilli e vlerëson kandidaten Joana Asimi Sorraj me **0 (zero) Pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

73. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

- “a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;
- b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;
- c) aftësitë e komunikimit;
- ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;
- d) aftësitë e përfaqësimit publik.”

74. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriteret vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

75. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 25 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 10 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 5 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 2 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 2 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, të miratuar me vendimin nr.52 datë 21.06.2019.

76. Në rastin e kandidatës Joana Asim Sorraj, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatës me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të kësaj candidate.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

77. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatës Joana Asimi Sorraj lidhur me qasjen dhe qëndrimet e tij mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbi sfidat kryesore me të cilat duhet të përballlet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në ushtrimin e përgjegjësve dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji, si edhe lidhur me mendimet e kandidatës për çështjet që duhet të trajtohen me përparësi e në perspektivë për mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e këtij institucioni të ri dhe shumë të rëndësishëm kushtetues, për ushtrimin efektiv dhe me nivel të lartë profesional e besueshmërie të kompetencave të tij në funksion të ndërtimit të një sistemi drejtësie të bazuar në integritetin profesional e moral, nisur edhe nga pritshmëritë e jashtëzakonshme të publikut pas miratimit dhe vënies në zbatim të reformës në drejtësi. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga kjo candidate gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

78. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidatja Joana Asimi Sorraj paraqiti një nivel shumë të mirë të njohjes dhe përvojës profesionale së saj në lidhje me rolin dhe pritshmëritë për ushtrimin e funksionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe elementë premtues që tregojnë cilësi, thellësi dhe origjinalitet për sa i përket sfidave me të cilat do të përballlet fillimisht krijimi i këtij institucioni, rekrutimi i inspektorëve të rinj nga rradhës e profesionistëve e personave me integritet, objektivat për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të

institucionit të ri kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke u vënë theksi te pavarësia e tij, respektimi i procesit të rregullt ligjor, zhvillimi i marrëdhënieve me publikun. Gjithashtu, kjo kandidatë parashtrori me maturi, në mënyrë profesionale e të hollësishme çështje dhe problematika të larmishme si ligore dhe organizative, me të cilat duhet të përballet Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

79. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*” nga kandidatët, Këshilli e vlerëson kandidaten Joana Asimi Sorraj me **6 (gjashtë pikë) Pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

80. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësi dhe ushtrimin e vendimmarrjes në përmbushjen e kompetencave dhe të detyrave të ngarkuara, veçanërisht për aspektet e drejtimit dhe të administrimit të punëve. Në këtë drejtim, Këshilli shqyrton dhe vlerëson posaçërisht aftësitë e provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësi si edhe për të marrë në vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

81. Në rastin e kandidatës Joana Asimi Sorraj, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatës, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

82. Këshilli vëren se kandidatja Joana Asimi Sorraj, është këshilltare ligjore pranë Komisionit të pavarur të kualifikimit duke dhënë ndihmë të drejtëpërdrejtë në realizimin e një procesi shumë të rëndësishëm kushtetues për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe ka një karrierë të gjatë në periudhën 2006-2013 si specialiste në fushën e marrëdhënieve me gjyqsorin pranë Presidentit të Republikës.

83. Status i veçantë në hierarkinë e shërbimit civil i mbajtur nga kandidatja konkretisht në rolin e specialistet profesionale për shqyrtimin e evidentimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe asistencë e vazhdueshme që ajo i ka dhënë organeve vendimmarëse në këtë drejtim dëshmojnë të dhëna premtuese për marrjen e përgjegjësi dhe nismës për vendimmarrje në përmbushjen e detyrave që i ka ngarkuar ligji, përfshirë edhe ato të lidhura me aspektet e administrimit dhe të drejtimit të institucioneve dhe njësisive përkatëse të administratës shtetërore.

84. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*”, Këshilli e vlerëson kandidaten Joana Asimi Sorraj me **5.8 (pesë pikë tetë) Pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

85. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, veçanërisht me nëpunësit dhe punonjësit e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, më organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe përfaqësuesit e tyre, me gjyqtarët dhe prokurorët, sikurse edhe në komunikimin dhe përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

86. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se kandidatja Joana Asmi Sorraj zotëron aftësi shumë të mira për të komunikuar me maturi, për të dëgjuar me respekt dhe për tu përgjigjur me profesionalizëm, qartësi e thjeshtësi, me stil dhe gjuhë të pasur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

87. Gjithashtu, referuar prezantimit të bërë gjatë intervistës, rezulton se kjo kandidatë zotëron edhe aftësi shumë të mira për përfaqësimin publik, prezanton thjeshtësi, aftësi për të shprehur bindjet e saj me vetëbesim. Kandidatja transmeton besueshmëri gjatë komunikimit dhe aftësi të dallueshme për tu përgjigjur me etikë pa krijuar konfuzion tek të tjerët, qofshin këta profesioniste të drejtës ose jo.

88. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik”*, Këshilli e vlerëson kandidatën Joana Asim Sorraj me **5 (pesë) Pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale

89. Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për vetë natyrën e këtij institucioni dhe funksioni, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të organizuar dhe për të qenë i përfshirë në punën në grup, me nëpunësit dhe punonjës e Zyrës së tij dhe për aq sa kërkohet dhe nevojitet me funksionarë e përfaqësues të institucioneve të tjera. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për tu përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

90. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se kandidatja Joana Asimi Sorraj zotëron aftësitë e duhura për të punuar në grup, përfshirë atë për të punuar në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore.

91. Gjithashtu, ushtrimi për një kohë të gjatë të detyrës së specialistet pranë këshilltarit juridik të Presidentit, specialistet të marrëdhënieve me gjyqsorin, keshilltares ligjore në komisionin e pavarur të kualifikimit për vetë mënyrën kolegjiale dhe punën në grup që kërkohet në këtë pozicione për përgatitjen e çështjeve për shqyrtim, bisedimin e zgjidhjes së tyre, i kanë mundësuar kësaj kandidatëje fitimin e përvojës dhe shprehive të duhura për punën në grup dhe në çështje e situata të larmishme. Zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.

92. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale*”, Këshilli vlerëson ti caktojë kandidatja Joana Asimi Sorraj **2 (dy) Pikë**.

Vlerësimi përfundimtar i kandidatës

93. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për këtë vend vakant, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidatja Joana Asimi Sorraj vlerësohet në total me **82.2 (tetëdhjetë e dy pikë dy) pikë**.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 147/d dhe pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 239 dhe 240 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të pikës 67 të të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “*Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidatës Joana Asimi Sorraj me **82.2 (tetëdhjetë e dy pikë dy) Pikë**, në lidhje me kandidimin e saj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI
Ardian DVORANI

